

Maskat maqedonase, vizirët, tunele për dezinfektim, skafanderë: Koronavirusi hapi edhe mundësi të reja biznesi

Fotografi profesionist Darko nga Shkupi, muajve të fundit për shkak të pandemisë së koronavirusit ngeli pa punë. Askush nuk e angazhon për dasma, sepse ato nuk po bëhen, ndërsa nuk ka as angazhime për pagëzime, e as për ivente afariste.

Ai bashkë me disa miq, që kanë përvojë për qepje, vendosi të bëjë maska mbrojtëse prej pambuku. E vuri në përdorim njohurinë e tij të mëparshme në marketing dhe për herë të parë në jetë edhe vetë mësoi të qepë në maqinë, rrefen ai për eMagazin.

Me shitjen e maskave nisi online, puna shumë shpejt pati sukses, siç thotë ai, ndërsa këtyre ditëve morën një porosi të rëndësishme prej një ndërmarrjeje të vendit.

“Nuk është koha për të qarë. Të gjithëve në këto kohë krize na duhet ndihmë, ndërsa të jemi të sigurtë, ajo nuk do të mbërrijë te secili. Në vend që të ankohe mi, duhet të punoni të marrin në duar tona fatin dhe të gjejnë mënyra të reja për të fituar”, thotë ai.

MASKATA MAQEDONASE DO TË SHITEN EDHE NË AMAZON

Shembullin e Darkos muajve të fundit e kanë ndjekur edhe disa ndërmarrje tekstili në Maqedoni, nga Prilepi, Shtipi, Kriva Pallanka...

Asnjëra prej tyre më parë nuk prodhonte maska mbrojtëse, të cilat në vend para krizës së “koronës” importoheshin nga Kina, ndërsa disa shkuan edhe më larg, nisën të prodhojnë edhe skafanderë, produkt që nuk prodhohet te ne në sasi të mëdha.

Kështu është shembulli i ndërmarrjes “Komfi angel” nga Prilepi, veprimtaria themelore e të cilës është prodhimi i jorganëve, jastëkëve, mbulesave...

Me paraqitjen e krizës së koronës, në këtë ndërmarrje, si dhe në disa të tjera në vend nisi prodhimi i maskave mbrojtëse prej pambuku, të cilat u dhuroheshin spitaleve, institucioneve shtetërore...

Sot të gjitha këto ndërmarrje tanimë prodhojnë maska jo vetëm për shitje në tregun e vendit, por edhe për eksport dhe jo vetëm të pambukut, por edhe medicinale.

“Aktualisht në javë prodhojmë 300 mijë maska. Në fillim të prodhimit të maskave blemë dy maqina, ndërsa gjatë kësaj periudhe investuam 200 mijë dollarë shtesë në një linjë të re

prodhimi, ku prodhimi i maskave medicinale do të rritet në 1.5 milionë në javë”, thotë për eMagazin, Jane Gjoreski, menaxher operativ në “Komfi angel”.

Maskat e tyre tani kryesisht shiten në barnatoret e vendit, ndërsa kompania tani më përfundon strategjinë për eksport më të madh jashtë vendit për të cilën flasin edhe investimet e reja.

“Shumë shpejtë maskat tona në bashkëpunim me partnerët tanë në Angli do të shiten edhe në Amazon”, thotë Gjoreski.

Për eksportin e maskave kirurgjikale jashtë vendit nevojitet certifikata EN 14683, e cila deri në fund të muajit ndërmarrja do ta fitojë nga laboratorit akredituar në Austri. “Komfo angel” punon edhe për sigurimin e CE siglës, e cila pritet ta fitojnë këtyre ditëve, dhe më pas deri te MALMED do të bëjnë kërkesë për lejen e prodhimit të pajisjes mbrojtëse medicinale.

Ndërmarrja njëkohësisht nisi edhe me prodhimin e skafanderëve, për të cilët nuk kërkohet certifikatë. Në javë këtu prodhohen prej 10 mijë deri në 12 mijë skafanderë, prej të cilëve 50 për qind eksportohen jashtë, kryesisht në Gjermani dhe Greqi.

“Më gjatë do të qëndrosh në treg nëse reagon shpejtë dhe përshtatesh ndaj asaj që kërkohet”, thotë Gjoreski.

Nga reklamat ndriçuese deri te vizirët

Përveç maskave mbrojtëse, pjesë e përditshmërisë në Maqedoni, ngadalë por sigurt, bëhen edhe vizirët mbrojtës.

Vizirët janë një nga mjetet e punës për puntorët e shëndetësisë, por edhe për stomatologët, frizerët, onduluesit..., ndërsa i kërkojnë edhe qytetarët e zakonshëm, që duan të bëjnë çmos për t'u mbrojtur nga koronavirusi.

Gjithashtu edhe ndërmarrjet e tekstitit, disa prej kompanive tona, në fillim për donacion për institucionet, pastaj edhe për shitje, nisën të prodhojnë edhe vizirë, që më herët nuk e praktikonin. Kështu është shembulli i ndërmarrjes së Ohrit “Peçat plus”, veprimtaria themelore e të cilës janë reklamat ndriçuese, ndërsa aty prodhohen edhe llambadar dhe tabakere.

Para ca kohe atje për herë të parë nisën të prodhohen edhe vizirë, Protect +.

Njëra nga veprimtaritë themelore edhe të ndërmarrjes së Shkupit “Multi media” është poashtu reklama ndriçuese, si dhe brendimi i pompave të benzinës, por edhe prodhimi i mobileve.

Edhe kjo ndërmarrje, duke marrë parasysh kushtet e reja të tregut këtë periudhë kohore ka nisur edhe me prodhimin e shtuar të vizirëve, por edhe të paravanëve mbrojtës pleksiglas.

Prej ndërmarrjes për eMagazin thonë se edhe më herët kanë prodhuar produkte të ngjashme, por ajo ka qenë incidentale, ndërsa kësaj periudhe për shkak të kërkesës më shumë janë të përqëndruar te ato.

TUNEL HIGJIENIK MAQEDONAS

E ngjashme është edhe historia e kompanisë së Gostivarit “Universal” e cila merret me prodhimin e pajisjes hotelierike dhe medicinale dhe e cila midis të parave në Maqedoni për herë të parë nisi të prodhojë “tunel higjienik” (sanitare gate), ku bëhet dezinfektimi gjatë hyrjes në objekt ku ka shumë vizitorë.

Erzen Nesimi, projektues në “Universal” për eMagazin thotë se ideja për këtë produkt e kanë marrë nga Italia.

“Para se të hyhet në objekt kalohet nëpër një zonë ku një dispanzer i përshtatshëm stërpikë preparat dhe në këtë mënyrë dezinfekton teshat.

Tani më ka shumë interes për këtë produkt, ndërsa në kompani tashmë shqyrtojnë edhe idenë për prodhime tjera, që aktualisht kërkohen në treg për shkak të pandemisë”, thotë Nesimi, i cili thekson se kompanitë duhet patjetër t’u përshtaten kushteve të reja dhe kërkesave të tregut.

“Për shkak të pandemisë, numri i porosive prej objekteve hotelierike, të cilët janë ndër klientët kryesor për shkak të veprimtarisë tonë themelore, nisi gradualisht të ulet. Siç dihet ato për shkak të “krizës me koronën” të parët u mbyllën.”

Pasi pamë se ka interes për këtë produkt prej disa objekteve vendosëm të investojmë më shumë mund në këtë drejtim, për të fituar të ardhura prej investimit”, thotë Nesimi.

Para do kohe edhe inovatorë nga Kavadari dhe Koçani nisën me prodhimin e tunelëve për dezinfektim.

EKSPORTI MAQEDONAS PËR PAJISJET MBORJTËSE U RRIË PËR 100 %

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, eksporti i maskave, skafanderëve dhe pajisjes tjetër mbrojtëse prej Maqedonisë është rritur thuhet për 300 % në prill krahasur me prillin e vitit të kaluar. Më shumë pajisje mbrojtëse sipas vlerës kemi eksportuar në Gjermani, Katar, Holandë, Belgjikë dhe Austri.

Këtë periudhë vlera e përgjithshme e këtij malli të eksportuar kap shumën prej 390 milionë denarëve, për dallim prej 135 milionë denarëve të realizuar në periudhën e njëjtë vitin e kaluar.

Ajo që është interesante është se te ne nisën të prodhohen edhe mbështjellës të maskave. Ekonomia maqedonase si dhe të gjitha të tjerat në botë mori goditje serioze për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Qeveria deri tani shpalli tri pako masash ekonomike, për efektin e të cilave në publik mendimet janë të ndryshme, por ajo për të cilën të gjithë janë të suigurtë, prej institucioneve financiare ndërkombëtare, Maqedonia në tremujorshin e parë të vitit do të hyjë në recesion.

Por, megjithatë këto shembuj tregojnë se edhe në këto kohëra të vështria nuk është krejt zi dhe se tregu gjithmonë ofron mundësi të reja për fitim dhe me këtë edhe ekzistencë.